
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CALCIBUS” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CALCIBUS” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“CALCIBUS” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“CALCIBUS”**, zoterohet nga ortaku:

1. Shoqeria e huaj e emertuar TECNOLAM SRL, e regjistruar me date 19.02.1996 me kod fiskal dhe numer regjistrimi 00665600417, me seli te aktivitetit te saj e ndodhur ne Colli Al Tetauro (PS) Via Flaminia Calcinelli, 2/B CAP61036 Saltara, Itali e perfaqesuar nga Z. Renato Briscolini i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. CA35868CR.

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“CALCIBUS” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“CALCIBUS” Sh.p.k.**

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Tefta Tashko, Pallati Nr. 20, H.14, Ap 10, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria " **CALCIBUS** " sh.p.k është e organizuar ne formen e nje shoqerie qe merret me:

- Tregtimin e produkteve TecnoLam Srl ne territorin shqiptar dhe ne vendet fqinje
- Projektimin dhe zhvillimin e produkteve te reja, nepermjet perdorimit te personelit te kualifikuar me kombesi shqiptare, me krikimin e nje Zyre Teknike ne territorin shqiptar, e afte per te operuar ne menyre autonome bazuar ne direktivat e shoqerise meme italiane TecnoLam srl. Shoqeria do te jete ne gjendje te kryeje cdo veprimtari tjeter ndihmese ose pergatitore te atyre te meparshme duke perfshire si shembull, por pa u kufizuar ne : ofrimin e sherbimeve te konsulences teknike dhe/ose tregtare, veprimtarite e ndermjetesimit tregtar, marrja e kontratave publike ose private, kryerja e veprimeve me pasuri te paluajtshme dhe financiare, marrja e kuotave ose anetaresimit ne konsorciume ose rrjete biznesi, administrimi ose marrja me qera te kompanive ose degeve te kompanive ne Shqiperi ose ne vende te tjera te huaja.

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 1.000 Euro (nje mije euro), i ndare në 1 (nje) pjese. Ne baze te kursit te Bankes se Shqiperise te dates 17.11.2023, vlere e kapitalit ne leke do te jete 103,950 (nje qind e tremije e nenteqind e pesedhjete). Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- Shoqeria e huaj e emertuar TECNOLAM SRL, e regjistruar me date 19.02.1996 me kod fiskal dhe numer regjistrimi 00665600417, me seli te aktivitetit te saj e ndodhur ne Colli Al Tetauro (PS) Via Flaminia Calcinelli, 2/B CAP61036 Saltara, Itali, e cila zoteron **nje kuote te barabarte me 100 % te kapitalit – ose ne vlere 103,950 Lekë** (njqind e tre mije e nenteqind e pesedhjete leke).

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**CALCIBUS**” **Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, eshte emeruar: Renato Briscolini, shtetas italian, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe i identifikuar me karte identiteti me nr CA35868CR.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

Tirane, 17/11/2023

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

CALCIBUS SHPK

“TECNOLAM SRL ”

*Perfaqesuar nga
Z. Renato Briscolini*



TECNOLAM S.r.l.
Via Flaminia n. 2/B
61036 Colli al Metauro (PU)
CF/P.I. 00665600417